



Special Prosecution Office of the Republic of Kosovo

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës

Kancelarija Specijalnoq Tužilaštva Republike Kosovo

29 12 2010

KA-208/10

Prishtinë, 29 Dhjetor 2010

PPS 117/2010

Gjykatës së Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica

Në pajtim me Nenet 304 (1), 305 dhe 306 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK), Prokurori i poshtë nënshkruar, dorëzon këtë:

Aktakuzë

Kundër:

Emri dhe mbiemri:

Pseudonimi

Data e lindjes

Emri i babës

Emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës

Profesioni

Vendbanimi

Vendi i lindjes

Numri i letërnjoftimit

Haki Hajdari

"Haki Drenica"

19 maj 1963

Teknik i makinerisë

Rr. Nak Berisha., Skenderaj/Srbica

Skenderaj/Srbica

1004789934

2.

Emri dhe mbiemri:

Pseudonimi:

Data e lindjes:

Emri i babës:

Emri dhe mbiemri i vajzërisë së nënës:

Profesioni

Vendbanimi:

Vendi i lindjes:

Numri i letërnjoftimit

Sali Rexhepi

"Sali Berisha"

12 korrik 1956

Mësues

Gjakovë/Djakovica

Fshati Rashkoc, Gjakovë/Djakovica

1009230218

Për krimet në vijim:

1. Haki Hajdari

- 1) **Krimet e Luftës Kundër Popullatës Civile**, e dënueshme sipas Nenit 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë, aktualisht i inkriminuar sipas

Nenit 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës sepse në kundërshtim të **Nenit 3 i përbashkët** me Konventën e Katërt të Gjenevës, të datës 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) të Protokollit II** të datës 8 Qershor 1977, plotësim i Konventës së Gjenevës të vitit 1949, të gjitha rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi kohën e konfliktit të armatosur në Kosovë dhe gjithë kohën relevante për kohën aktuale, i **pandehuri**, në cilësinë e anëtarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) duke mbajtur pozita komanduese në kampin e Cahanit, në bashkëpunim me Riza Aliajn, Sali Rexhepin dhe anëtarë tjerë deri tani të paidentifikuar të UÇK-së, kanë trajtuar në mënyrë ç'njerëzore (p.sh. kushtet të fëlliqta të jetesës, mungesë të sanitarisë, ushqim dhe ujë) një numër i pa definuar, mirëpo më i madh se pesë, të burgosurve të mbajtur në burgun e improvizuar përbrenda kampit të Cahanit; në Cahan (Shqipëri), nga prilli deri në mesin e qershorit 1999.

- 2) **Krimet e Luftës Kundër Popullatës Civile**, e dënueshme sipas Nenit 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës sepse në kundërshtim të **Nenit 3 i përbashkët** me Konventën e Katërt të Gjenevës, të datës 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) të Protokollit II**, të gjitha rregulloret të ligjit ndërkombëtar efektiv gjatë konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për aktvendimin prezent, i pandehuri, në kapacitetin e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëpunim me Sali Rexhepin dhe tre pjesëtarë të UÇK-së deri tani të paidentifikuar torturuan Dëshmitarin N, një shqiptar i Kosovës që ishte ndaluar në kampin e Cahanit, duke tentuar që të marrin informata nga ai dhe që ai të pranojë duke e rrahur vazhdimisht me shufra të drurit; në Cahan (Shqipëri), me ose 3 maj 1999.

2. Sali Rexhepi

- 1) **Krimet e Luftës Kundër Popullatës Civile**, e dënueshme sipas Nenit 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës sepse në kundërshtim të **Nenit 3 i përbashkët** me Konventën e Katërt të Gjenevës, të datës 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) të Protokollit II**, të gjitha rregulloret të ligjit ndërkombëtar efektiv gjatë konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevante për aktvendimin prezent, i pandehuri, në kapacitetin e tij si pjesëtar i UÇK-së duke mbajtur pozita komanduese në kampin e Cahanit, në bashkëpunim me Riza Aliajn, Haki Hajdarin dhe pjesëtarë tjerë deri tani të panjohur të UÇK-së, kanë trajtuar në mënyrë ç'njerëzore (p.sh. kushtet të fëlliqta të jetesës, mungesë të sanitarisë, ushqim dhe ujë) një numër i pa definuar, mirëpo më i madh se pesë, të burgosurve të mbajtur në burgun e improvizuar përbrenda kampit të Cahanit; në Cahan (Shqipëri), nga prilli deri në mesin e qershorit 1999.
- 2) **Krimet e Luftës Kundër Popullatës Civile**, e dënueshme sipas Nenit 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës sepse në kundërshtim të **Nenit 3 i**

përbashkët me Konventën e Katërt të Gjenevës, të datës 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) të Protokollit II**, të gjitha rregulloret të ligjit ndërkombëtar efektiv gjatë konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevant për aktvendimin prezent, i pandehuri, në kapacitetin e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëpunim me Haki Hajdarin dhe tre pjesëtarë të UÇK-së deri tani të paidentifikuar torturuan Dëshmitarin N, një shqiptar i Kosovës që ishte ndaluar në kampin e Cahanit, duke tentuar që të marrin informata nga ai dhe që ai të pranojë duke e rrahur vazhdimisht me shufra të drurit; në Cahan (Shqipëri), me ose 3 maj 1999,

- 3) **Krimet e Luftës Kundër Popullatës Civile**, e dënueshme sipas Nenit 22 dhe 142 të Kodit Penal të Republikës Federale të Jugosllavisë, aktualisht i inkriminuar sipas Nenit 23 dhe 120 të Kodit Penal të Kosovës sepse në kundërshtim të **Nenit 3 i përbashkët** me Konventën e Katërt të Gjenevës, të datës 12 Gusht 1949, si dhe sipas **Nenit 4 dhe 5 (1) të Protokollit II**, të gjitha rregulloret të ligjit ndërkombëtar efektiv gjatë konfliktit të brendshëm në Kosovë dhe gjatë gjithë kohës relevant për aktvendimin prezent, i pandehuri, në kapacitetin e tij si pjesëtar i UÇK-së, në bashkëpunim me dy pjesëtarë tjerët të paidentifikuar të UÇK-së, kanë torturuar Dëshmitarin N, një shqiptar Kosovar i mbajtur në kampin e Cahanit; më hollësisht, i pandehuri ka marrë pjesë në këtë krim duke tentuar të marrë informata dhe pranimin nga Dëshmitari N. deri sa ishte rrahur nga një pjesëtar i UÇK-së deri tani i panjohur në duart dhe këmbët e tij; në Cahan (Shqipëri), me ose rreth 9 majit 1999.

BAZAT PËR AKTAKUZË DHE PASQYRË E PROVAVE

1. Hetimet në rastin aktual kanë origjinar nga deklaratat e tubuara nga disa dëshmitarë (Dëshmitari L, Dëshmitari N, Dëshmitari K, Dëshmitari M) gjatë hetimeve PPS 08/09 kundër Sabit Gecit et al. Me rëndësi të posaçme për hetimet aktuale janë deklaratat e dhëna nga Haki Hajdari dhe Sali Rexhepi në cilësinë e dëshmitarëve më 15 qershor 2010 dhe përkatësisht më 13 korrik 2010.
2. Dëshmitari N është dëgjuar si shtesë në cilësinë e dëshmitarit nga Prokurori i poshtë nënshkruar më 2 dhjetor 2010. Në bazë të deklaratës së tij shtojcë, janë hapur hetime të reja kundër Haki Hajdarit dhe Sali Rexhepit. Këta dy të pandehur janë marrë në pyetje në cilësinë e të pandehurve më 15 dhjetor 2010.
3. Provat e tubuara, dhe posaçërisht deklaratat e dhëna nga Dëshmitari L, Dëshmitari N, Dëshmitari K dhe Dëshmitari M gjatë hetimeve nr. 08/09, e mundësojnë Prokurorin të konkludojë se në vitin 1999 UÇK-ja e udhëhiqte një kamp ushtarak që përbëhej nga ca baraka që gjendeshin në Cahan (Komuna e Krumës, Shqipëri).
4. UÇK-ja përdorte disa lokale brenda kampit për t'i mbajtur njerëzit duke përfshirë civilët siç ishin Dëshmitari L, Dëshmitari N, Dëshmitari M dhe Dëshmitari K. Të burgosurit e mbajtur në Cahan ishin nënshtrua ndaj formave të ndryshme të abuzimit fizik dhe mental. Të burgosurit ishin nënshtruar ndaj rrahjeve, torturave, izolimit dhe mbaheshin në qeli të stërmbohura, me kushte jo të shëndetshme dhe të ndyra.
5. Dëshmitari L dhe Dëshmitari N dëshmuar se Haki "Drenica" ishte Komandant i

Përgjithshëm i kampit. Ishte po ashtu edhe deklarata e Dëshmitarit M se "Komandant Drenica" ishte prezantuar në cilësinë e komandantit të rrethit të Krumës. Të burgosurit e kishin parë Haki "Drenicën" në Cahan rregullisht.

6. Dëshmitari L dëshmoi se Sali Rexhepi ishte komandant brenda kampit të Cahanit, i caktuar në veçanti për lokalet ku mbaheshin të burgosurit. Ishte dëshmia e Dëshmitarit N se Sali "Berisha" ishte njëri prej personelit që e udhëhiqte kampin e Cahanit, bashkë me Haki "Drenicën" dhe Komandant Hoxhën. Të burgosurit e kishin parë Sali "Berishën" në Cahan rregullisht.

7. Dëshmitari L dhe Dëshmitari N dëshmuan se rreth 20 majit 1999 Haki "Drenica" dhe Sali "Berisha" i morën ata në Kukës për t'u gjykuar. Edhe pse vendimi i gjyqtarit ishte që të liroheshin të dy Dëshmitari L dhe Dëshmitari N sepse ata nuk ishin shpallur fajtorë për asgjë, Haki "Drenica" vendosi që të mos vepronte ashtu, dhe bashkë me Sali "Berishën" i kthyen ata në burgun e kampit të Cahanit.

8. Prandaj është e qartë nga siç është thënë këtu më lartë se të dytë Haki Hajdari dhe Sali Rexhepi kishin pozita të përgjegjësive në kampin e Cahanit. Ata vullnetarisht kishin kontribuar me veprimet e tyre në burgosjen e personave të mbajtur në burg në Cahan, si dhe për kushtet jonjerëzore që aplikoheshin ndaj të burgosurve.

* * * * *

9. Dëshmitari N po ashtu dëshmoi se pas ardhjes në Cahan, më apo rreth 3 majit 1000, ishte rrahur nga Haki "Drenica", Sali "Berisha", dhe tre ushtarë tjerë të UÇK-së ende të paidentifikuar.

10. Këta pesë persona, së pari ia lidhën duart e Dëshmitarit N pas shpine dhe ia zbathën këpucët dhe çorapet. Pastaj katër prej tyre, duke përfshirë Haki "Drenicën" dhe Sali "Berishën", të gjithë, me përjashtim të personit të pestë të panjohur, e rrahën këmbëve dhe shputave me shkopinj prej druri. Dëshmitari N u rrëzua në tokë dhe nuk mund të lëvizte dot. Rrahjet përcilleshin me marrje në pyetje lidhur me kinse anëtarësimin në Partinë Socialiste të Serbisë si dhe me anëtarësimin e gruas së tij të pretenduar në LDK.

11. Për shkak të dhimbjes shumë të madhe në shputa dhe në këmbë, dëshmitari N nuk mundi me ecën por shkonte vetëm zvarritej.

12. Veç kësaj, Dëshmitari N po ashtu dëshmoi se pesë apo gjashtë ditë pas rrahjes së parë, dmth. më 8 apo 9 maj 1999, ai ishte rrahur nga një person i panjohur. Sali "Berisha" dhe një ushtar i UÇK-së deri më tani i paidentifikuar ishin të pranishëm dhe, deri sa personi i paidentifikuar ishte duke e rrahur Dëshmitarin N këmbëve dhe duarve me një shkop prej druri, ata i bënë pyetje. Personi i panjohur po ashtu bënte pyetje në të njëjtën kohë deri sa e rrihte.

13. Gjatë intervistimit të dëshmitarit më 2 dhjetor 2010, Dëshmitari N e identifikoi Haki Hajdarin dhe Sali Rexhepi si Haki "Drenica" dhe Sali "Berisha" në fotografitë që iu ishin treguar.

14. Gjatë marrjes së tij në cilësinë e të dyshuarit nga ana e Prokurorit të poshtë nënshkruar më 15 dhjetor 2010, Haki Hajdari konfirmoi deklaratën e tij të dhënë më herët në cilësinë e dëshmitarit më 15 qershor 2010. Ai pra e konfirmoi se në vitin 1999 ishte anëtar i UÇK-së i caktuar në departamentin e logjistikës në kampin e Cahanit. Ai deklaroi

se roli i tij ishte të grumbullonte armë nga vende të ndryshme të Shqipërisë, t'i sillte ato në Cahan dhe pastaj t'i dërgonte në Kosovë. Ai deklaroi se, në mesin e ushtarëve tjerë të UÇK-së, ai i kishte parë Sali Rexhepin dhe Riza Aliajn në Cahan rregullisht.

15. Gjatë marrjes së tij në pyetje në cilësinë e të pandehurit nga ana e Prokurorit të poshtë nënshkruar më 15 dhjetor 2010, dhe në praninë e Avokatit tij të Mbrojtjes sipas zgjedhjes së tij, Sali Rexhepi po ashtu e konfirmoi deklaratën të cilën e kishte dhënë më 13 korrik 2010. Ai pra në këtë mënyrë konfirmoi se në vitin 1999 kishte qenë ushtar i UÇK-së i stacionuar në Cahan, duke kryer detyra të zakonshme ushtarake. Ai më tutje deklaroi se Haki "Drenica" ishte përgjegjës për kamp, deri sa Riza Alija ishte një ushtar i UÇK-së që ishte i stacionuar aty. Së fundi, ai deklaroi se ai kishte parë dhe ishte takuar me civil në Cahan, në mesin e të cilëve i kujtohej edhe Dëshmitari L.

* * * * *

16. Ekziston një praktikë e mirënjohur e përcaktuar kombëtare dhe ndërkombëtare në të cilën deklarohet se në mars të vitit 1999 ekzistonte një konflikt i armatosur në mes të forcave serbe dhe të UÇK-së i cili zhvillohej në territorin e Kosovës.

17. Fakti se aksionet kishin ndodhur jashtë territorit të Kosovës, ashtu siç kishte vendosur Gjykatësi për Konfirmimin e Aktakuzës në rastin paralel PPS 08/09 kundër Sabit Gecit et al., nuk e përjashtojnë zbatimin e Nenit të Përgjithshëm 3 si dhe Ligjin Ndërkombëtar mbi Drejtat e Njeriut në përgjithësi.

18. Veprimet e të pandehurve prandaj përbëjnë Krime të Luftës kundër popullatës civile, duke marrë parasysh se ato në mënyrë të qartë shkelin dispozitat e Neneve 22 dhe 142 të Kodit Penal të RFSJ-së (e njëjta vepër është kriminalizuar sipas Neneve 23 dhe 121, par 2 të KPK-së) dhe e shkelin Nenin 3 të Konventës së Gjenevës të 12 gushtit 1949 dhe Nenin 5 të Protokollit II të 8 qershorit 1977, Shtojcë e Konventave të Gjenevës së vitit 1949, të gjitha rregullat e të drejtës ndërkombëtare në fuqi në atë kohë të konfliktit të brendshëm të armatosur në Kosovë.

19. Së fundi, nuk ka dyshim se viktimat e Haki Hajdarit dhe Sali Rexhepit ishin civilët, të cilët nuk kishin marrë pjesë fare në veprimet ushtarake, të cilët ishin bërë cak për shkak të jo lojalitetit të tyre të vërtetë, të supozuar apo të pretenduar ndaj UÇK-së.

PROPOZIM PËR GJYKIM

Prokurori propozon që gjykimi kryesor i këtij rasti të caktohet dhe të mbahet në Gjykatën e Qarkut në Mitrovicë/Mitrovica.

Prokurori kërkon që personat e poshtë shënuar të ftohen për të marrë pjesë:

- Prokurori i poshtë nënshkruar;
- Të pandehurit Haki Hajdari dhe Sali Rexhepi, dhe Avokatet e tyre Mbrojtës;
- Palët e Dëmtuara, Dëshmitari N, Dëshmitari L, Dëshmitari K dhe Dëshmitari M.

Prokurori propozon që në gjykimin kryesor të dëgjohen dëshmitarët e poshtë

shënuar:

- Dëshmitari N
- Dëshmitari L
- Dëshmitari K
- Dëshmitari M

Prokurori më në fund propozon që deklaratat e e të akuzuarve të pranohen në cilësinë e provave.

Maurizio Salustro

Prokuror i PSRK-së

